



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:104546

Datë: 14.03.2025

Numri i dokumentit: 06995103

PKR.nr.26/2007

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Xhemajl JUSUFI, anëtarë të trupit gjykues, gjyqtarët Ali KUTLLOVCI dhe Dardane ISMAILI, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI dhe zyrtaren ligjore Doruntina BEKA, në lëndën penale ndaj të pandehurit L.A., për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 30 alinea 1 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (*tutje si*: LPK), lidhur me nenin 19 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (*tutje*: LPJ), duke vendosur sipas Aktakuzës së ish Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë, Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP.nr.125/02, të datës 17.05.2002, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 13.02.2025, në prezencën e Prokurorit të Shtetit, Fetije Bajrami, i pandehuri L.A., mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare, avokat Rexhep Kaçaniku, dhe dëshmitarët SH.O. dhe K.M., me datë 14.02.2025 e shpalli publikisht, ndërsa me datë 14.03.2025 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

L.A., nga i ati B., e ëma M., e vajzërisë T., i lindur me datë, në Mitrovicë, me vendbanim në Klinën e Epërme, Komuna Skenderaj Mitrovicë, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i martuar, baba i katër fëmijëve, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në mbështetje të nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së.

LIROHET NGA AKUZA

Sepse nuk është vërtetuar se:

Më datën 20 Shkurt të vitit 2002, në intervalin kohor prej orës 19,00-20,00, në autobusin e NPT “H.T.”, në relacionin Skenderaj – Mitrovicë, afër fshatit Kline e Mesme, me dashje ka filluar kryerjen e veprës penale të vrasjes por nuk e ka përfunduar pasi që ka penguar të pranishmit, në atë mënyrë që pas ngatërresës verbale ka tentuar të privoi nga jeta A.D. në atë mënyrë që disa herë i ka ra grushte kokës pastaj ka nxjerr thikën dhe ka dashtë që të prej në fyt, por që në atë moment është penguar nga i pranishmi – konduktori E.U. i cili ka ndërmjetësuar dhe në atë rast ka pësuar plagosje të lehtë trupore në dorën e djathtë në mes të gishtit të madhe dhe gishtit tregues.

-Me këtë kishte për të kryer veprën penale: Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së lidhur me nenin 19 të LPJ-së.

- Në mbështetje të nenit 276 paragrafi 1 dhe 2, nën paragrafi 2.1 të KPP-së, të pandehurit i konfiskohen sendet dhe atë: armë-thikë 7.3 cm. Urdhërohet Policia e Kosovës që armën e konfiskuar ta shkatërroj sipas procedurave ligjore në fuqi.

-Shpenzimet e procedurës penale, mbulohen nga mjetet buxhetore të kësaj Gjykate.

-Pala e dëmtuar, E.U., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës:

Ish-Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur Aktakuzën PP.nr.125/2002, të datës 17.05.2002 ndaj të pandehurve L.A. për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së lidhur me nenin 19 të LPJ-së, dhe të pandehurit A.D. për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPPK-së.

Sa i përket pikës së II të dispozitivit ndaj të pandehurit A.D., i akuzuar për shkak veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të

KPPK-së, për të njëjtin gjykata me Aktvendim të veçantë kishte hedhur aktakuzën dhe kishte pushuar procedurën për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

Bazuar në dispozitat procedurale të cilat ishin në fuqi në atë kohë, konfirmimi i aktakuzës ndaj të pandehurit ishte bërë me datë 16.04.2007, përmes Aktvendimit P.nr.26/2007, nga ish gjyqtarja për konfirmim të aktakuzës, të asaj kohe, pas mbajtjes së seancës për konfirmimin e aktakuzës në të njëjtën datë, pra 16.04.2007.

Gjykata, lidhur me këtë çështje penale, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 13.02.2025, ashtu që në këtë seancë, i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor, është dëgjuar dëshmia e dëshmitarit SH.O. dhe K.M., janë lexuar deklaratat e dëshmitarëve S.A., Bahri Hasani dhe E.U., janë administruar provat materiale dhe palët kanë paraqitur fjalën përfundimtare.

-Fjala përfundimtare e palëve:

Prokurori i Shtetit, Fetije Bajrami, në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se: mbetet në tërësi pranë aktakuzës kundër të pandehurit L.A. për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së lidhur me nenin 19 të LPJ-së, se i pandehuri e ka kryer veprën penale vërtetohet nga deklaratat e të dëshmitarëve okular të cilët kanë qenë prezent në ditën kritike, dëshmitari E.U. ne deklaratën e dhënë në polici menjëherë pas kryerjes së veprës penale, ka deklaruar se e ka parë L. ulur bashkë me A. në autobus, Luigji e ka nxjerrë thikën duke dashur t'ia hjekë kryt A., në atë moment ja ka kapur thikën që të mos e lëndoj A., L. ja ka kapur dorën dhe dëshmitari është prerë me thikë në dorë. Gjithashtu nga deklarata e dëshmitarit K.M. ka rezultuar se ka qenë në autobus, i ka parë se si kanë dashur të rrahën L. me A. ku kishte ndërhyrë konduktori E.U., i cili është lënduar nga thika i cili ka deklaruar se ata kishin pasur thika me veti. Po ashtu i njëjti kishte deklaruar se kishte vërejtur Luigjin se kishte nxjerrë thikën me dorën e majte, ja kishte kapur kokën A. duke e tërhequr mbrapa, thikën ja kishte afruar 3 cm deri te fytit, dhe nga frika A. kishte shkuar të vozitësi, udhëtarët kishin intervenuar dhe L. e kishin larguar nga autobusi. Nga foto dokumentacioni i shkresave të lëndës shihet thika që është përdorur nga i pandehuri në ditën kritike, duke tentuar ta privoj nga jeta të dëmtuarin A.D., e cila thikë është konfiskuar nga policia.

Përfundimisht, gjykatës i ka propozuar që ti merr parasysht deklaratat e dëshmitareve SH.O., S.A. dhe B.H.dhe ti jap besimin, të cilët kanë deklaruar në polici menjëherë mbas kryerjes së veprës

penale nga i pandehuri, të pandehurin ta shpallë fajtor, dhe me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të merr parasysh të gjitha rrethanat rëndësuese dhe lehtësuese.

Mbrojtësi i të pandehurit L.A., avokat Rexhep Kaçaniku, në fjalën përfundimtare të tij, ka deklaruar se: i mbrojturi i tij nga prokuroria e shtetit është akuzuar me datë 20.02.2002, i cili paska tentuar të vrasë të dëmtuarin A.D.. Më tej, mbrojtësi ka theksuar se kjo veprë penale kryhet me dashje direkte kur kryesi dëshiron të kryejë këtë veprë por jo të pajtohet me të, të gjitha deklaratat e dëshmitarëve janë deklarata sipërfaqësore, dëshmitari E. prejudikon çështjen kur thotë se ka dashur ta vras A. e po ashtu nga gjatë shqyrtimi gjyqësor të gjithë dëshmitarët janë deklaruar se ka kaluar kohë e gjatë dhe nuk ju kujtohen detajet. Tutje, mbrojtësi i të pandehurit ka shtuar se nuk është kontestuese se A. ka poseduar një sprej, por është kontestuese se si L. ishte afruar A., dhe E. kishte intervenuar ndaj tyre dhe nga momenti i ngritjes nga fundi i autobusit dhe afrimi tek L. kishte kaluar kohë e gjatë sikur donte ta vriste A., por që i njëjti nuk ka dashur ta vrasë por vetëm ta frikësoj. Që nga ajo kohë e deri më sot i pandehuri dhe i dëmtuari shoqërohen sikurse të mos kishte ndodhur asgjë, pra të dy janë pajtuar. Andaj nuk manifestohen tiparet qenësore të veprës penale për të cilën akuzohet, por të veprës penale të Rrezikimit, për të cilën ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes dhe në mundësi të fakteve relevante i ka propozuar gjykatës që të marr aktgjykim lirues për të mbrojturin e tij.

I pandehuri L.A., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështet fjalën e mbrojtësit dhe nuk ka se çfarë të shtoj.

Provat e administruara-

Gjykata, gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, administroi provat si në vijim:

- Fotografi, në të cilën shihet një (1) thikë
- Raporti i hetuesit, i datës 09.03.2002.

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka dëgjuar dëshmitarët SH.O. dhe K.M., ndërsa që nuk ka arritur të dëgjoj të dëmtuarin e vetëm të propozuar në aktakuzë, E.U., kjo pasi që me gjithë përpjekjet e gjykatës për të siguruar prezencën e të njëjtit në shqyrtim gjyqësor, nga raporti zyrtar i Policisë së Kosovës, rezulton se i njëjti gjendet jashtë vendit dhe adresa e saktë nuk dihet.

Gjykata nuk ka arritur të dëgjoj as dëshmitarin S.A. kjo pasi që me gjithë përpjekjet e gjykatës për të siguruar prezencën e të njëjtit në shqyrtim gjyqësor, nga raporti zyrtar i Policisë së Kosovës i datës 13.11.2024, konstatohet sipas familjarëve të tij se i njëjti tash e disa vite jeton dhe punon në Suedi, gjithashtu nuk është dëgjuar as dëshmitari B.H. i cili ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt përmes procesverbalit të datës 23.12.2024.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 13.02.2025, është dëgjuar dëshmitari SH.O., i cili mes tjerash ka deklaruar se nuk i kujtohet rasti në detaje, mbetet pranë deklaratës së dhënë, nuk i kujtohet ditën kritike ku ka qenë duke shkuar, i njeh personat L.A., A.D., B.H., E.U., S.A., por nuk e njeh K.M.. Ditën kritike nuk i kujtohet se çfarë kishte ndodhur në autobus, ku ka qenë ulur dhe po ashtu se si ishte zhvilluar ngjarja mes L. dhe A.. Gjithashtu ka theksuar se jashtë deklaratës së dhënë në polici nuk ka se çfarë të shtoj pasi që nuk i kujtohet nëse kishte tentuar L. apo A. të sulmojnë njëri tjetrin, nuk ka dashur që kjo ngjarje të bëhet më e madhe pasi që nuk ishin njerëz të problemeve. Ndërsa në deklaratën e dhënë në polici me datë 02.03.2002 dëshmitari ndër të tjera kishte theksuar se ditën kritike kishin hipur në autobus ku ishin ulur në ulëset e pasme të autobusit dhe për një moment kishte ardhur A.D., kishin biseduar diçka me L. ku pas një tollovi ishin ndalë dhe kishin zbritë në Skenderaj, ndërsa më vonë duke u kthyer në shtëpi, L. deshi të bisedoj me A. për problemin që e kishin më parë mirëpo A. nuk deshti të bisedonte dhe në një moment e nxori prej duke e sulmuar L., me ç'rast u krijua një tollovi ku derisa dëshmitari po e nxirrte jashtë L. shoqëria e A. e godisnin të njëjtin e ku pas kësaj të njëjtit i nxorën jashtë autobusit dhe në këmbë kanë shkuar në shtëpi.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 13.02.2025, është dëgjuar dëshmitari K.M., i cili mes tjerash ka deklaruar se nuk i kujtohet asgjë për rastin, mbetet pranë deklaratës së dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës 01.06.2022, në të cilën po ashtu kishte deklaruar se asgjë nuk i kujtohet nga rasti që ka ndodhur. Në deklaratën që kishte dhënë në polici me datë 21.02.2002, dëshmitari ndër të tjera kishte theksuar se kishte qenë në autobus në relacionin Skenderaj-Mitrovicë dhe në autobus ishin tre djem nga Klina e Epërme dhe atë S.O., L.O. dhe SH.O.. Sipas këtij dëshmitari këta të tre tentuan ta zbresin nga autobusi shokun e tij A.D. me qëllim për ta rrahur. Më tej në këtë deklaratë dëshmitari kishte deklaruar se ata kishin qenë të ulur mbrapa A. ku edhe kanë tentuar ta therrin me thikë A., ndërsa në atë moment kanë ndërhyrë konduktori i autobusit E.U., i cili në këtë rast është prerë me thikë nga L.. Në këto momente kishin ndërhyrë për ti ndarë dhe pas kësaj L. me shokët e tij i kishin larguar nga autobusi. Ka theksuar se këta djem kishin thika me vete si dhe një revole e shufër hekuri.

Dëshmitari K.M. me datë 12.01.2004 kishte dhënë dëshminë e tij edhe para në atë kohë gjyqtarit hetues ku ndër të tjera kishte deklaruar se kur L. ishte ulur pas tyre, dëshmitari i kishte propozuar A. që të ngritej nga ai vend sepse e kishte parandje se do të ndodhte diçka. Në atë moment L. ishte ngritur, e kishte nxjerrë thikën me dorë të majtë, e kishte mbështjellë kokën e A. në pjesën e ballit, pak e ka tërheq mbrapa dhe e kishte afruar thikën diku tre cm në afërsi të fytit, më afër nuk ka mundur pasi që A. nga frika me vrull është ngritur dhe përmbi ulëse ka shkuar në pjesën e parë të autobusit tek konduktori dhe shoferi. Në këtë moment konduktori E.U. është ngritur dhe e ka kapur L. për dorë duke tentuar të ja marr thikën, pas një kohe L. e kanë larguar nga autobusi dhe kanë vazhduar rrugën pa të.

Siç u theksua më lart, në pamundësi për të siguruar prezencën e dëshmitarëve S.A., B.H. dhe E.U., për arsyet si më lart, trupi gjykues, bazuar në dispozitën e nenit 335 paragrafi 1, në paragrafi 1.1 dhe 1.3 të KPP-së, ka lexuar deklaratat e këtyre dëshmitarëve S.A. dhe B.H. të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 14.07.2022 dhe të dëmtuarit E.U. të dhënë në polici me datë 21.02.2002 dhe deklaratën në Gjykatën e Qarkut pranë gjyqtarit hetues me atë 12.01.2004.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 14.07.2022, dëshmitari S.A. kishte theksuar se nuk i kujtohet shumë ngjarja që ka ndodhur ditën kritike, në të cilin kishte deklaruar se mes L. dhe A. ka pasur konflikt të vogël, A. kishte poseduar sprej, dhe L. kishte poseduar një brisk. I njëjti dëshmitar në deklaratën që kishte dhënë në polici dëshmitari kishte konfirmuar se në autobus kishte qenë me shokët e tij L. dhe Sh. ku të njëjtit kishin qenë ulur në ulëset e pasme të autobusit ndërsa përpara kishte qenë ulur A. dhe momentin që ky i fundit kishte vërejtur prezencën e tyre ishte ulur në një ulëse me L. i cili e kishte nxjerrë sprejin dhe ka dashtë të ia hedhë L., mirëpo që kishte ndërhyrë pronari i autobusit me emrin E. dhe i kishte ndarë. Pasi që janë kthyer nga Skenderaji me autobusin e njëjtë, L. kishte shkuar te A. se çfarë i kishte borxh dhe në atë moment A. i kishte nxjerrë sprejin ndërsa L. thikën në vet mbrojtje me q ‘rast kishte ndërhyrë pronari i autobusit E. i cili e kishte kapur thikën e L. me dorën e djathtë ku edhe ishte prerë në dorë e pas kësaj kishte ndërhyrë dëshmitari për ti ndarë ku edhe kishte marrë thikën nga L. dhe kishin zbritur nga autobusi.

Dëshmitari S.A. në deklaratën e datës 12.01.2004 të dhënë para në atë kohë gjyqtarit hetues kishte deklaruar se në ditën kritike L. pa dashje kishte shkelur në këmbë një djalosh të ri të cilin edhe e kishte shtyer pak, Luigji i kishte kërkuar falje mirëpo atij djaloshit nuk i mjaftonte kjo, mirëpo

menjëherë A. me shoqërin e tij iu kanë vërsulur L. duke e sulmuar me grushta ndërsa L. nga frika e kishte nxjerrë një brisk të vogël për ta frikësuar A. dhe sh. e tij ku në atë moment E.U. nga frika se mos L. po e lëndon dikë, iu ka afruar dhe ia ka kapur thikën.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 14.07.2022, dëshmitari B.H., i njëjti kishte theksuar se, nuk e kishte parë ngjarjen pasi që kishte qenë duke e drejtuar autobusin, pas një mosmarrëveshje që disa persona kishin pasur me A., iu kam drejtuar që të dalin jashtë autobusit dhe se detajet tjera nuk i kujtohen pasi ka kaluar kohe e gjatë.

Ky dëshmitar edhe në polici me datë 21.02.2002 por edhe para gjyqtarit hetues me datë 12.01.2004 kishte deklaruar se nuk e kishte parë në tërsi ngjarjen por kishte dëgjuar disa zhurma, kishte vërejtur se këtu i pandehuri L. kishte një thikë në dorë si dhe kishte vërejtur se nën punësi i tij E. duke dashur t'i ndajë personat në konflikt, kishte pësuar një prerje në dorë.

I dëmtuari E.U., në deklaratën e dhënë në polici dhe para Gjyqtarit hetues mes tjerash ka deklaruar se, ditën kritike ka qenë në cilësinë e konduktorit me autobusin në të cilin ka ndodh ngjarja, kur ka arritur në diku te fshati Klinë e Mesme e ka vërejtur të pandehurin L.A. që po tenton të theri me thike A.D. Më tej kishte deklaruar se kishte qenë në këmbë në autobus duke bërë pagesën dhe ka qenë afër L., e ka kapur për dore me të cilën mbante thikën në mënyrë që mos ta godas A. me c`rast është prerë në dorën e djathtë ne mes gishtit tregues dhe gishtit të madh.

Pas administrimit të provave, i akuzuari L.A., nuk e ka paraqitur mbrojtjen e tij, dhe ka theksuar se qëndron pranë deklaratave që ka dhënë në fazën e hetimeve, ku mes tjerash kishte deklaruar se, ditën kritike kishte qenë së bashku me vëllain e tij S. dhe kushëririn SH.O., kishte ndodhur një mosmarrëveshje mes tij dhe A.D, pasi që pa dashje e ka shkelur me këmbë një kushëri të tij, për këtë A. ishte zemëruar shumë, e ka nxjerr sprejin prej xhepi, nga frika, i pandehuri e ka nxjerr thikën nga xhepi në mënyrë që të mbrohet, nuk ka tentuar ta sulmoj e as ta privoj nga jeta askënd, nuk e ka goditur askënd, ndërsa konduktori E. duke ja marr thikën, është lënduar.

Gjetjet e gjykatës:

Gjykata, pasi ka administruar provat personale dhe materiale, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv.

Për gjykatën, nuk është kontestues fakti se ditën kritike, në autobusin NPT “H.T.”, në realacionin Skenderaj – Mitrovicë, afër fshatit Klinë e Mesme, ka ndodhur një konflikt në mes të pandehurit L.A. dhe A.D..

Gjithashtu nuk është kontestues fakti se i pandehuri Luigj nuk e ka goditur me thikë personin A.D. në ditën kritike dhe ky fakt është pohuar nga të gjitha palët e përfshira në këtë rast.

Gjithashtu nuk është kontestuese se në ditën kritike, i pandehuri A. kishte me vete një thikë i cili fakt përveç se provohet nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, nuk mohohet as nga vet i akuzuari L.

Nuk është kontestuese as fakti se gjatë përleshjes, A.D. nuk kishte pësuar lëndime, mirëpo lëndime kishte pësuar E.U. i cili gjatë përplekjes së tij për t’i ndarë L. me A. ishte prerë në dorë.

Gjithashtu nuk ishte kontestues fakti se para se të ndodhte kjo ngjarje sipas përshkrimit faktik të dispozitivit të aktakuzës, i pandehuri L.me personin A.D., derisa po udhëtonin nga Mitrovica për në Skenderaj, kishin pasur një diskutim mes tyre.

Këto fakte, përveç që nuk janë kontestuar nga i akuzuari, vërtetohen edhe nga provat e administruara, respektivisht nga provat materiale dhe deklaratat e të dëmtuarit dhe dëshmitarëve.

Kontestuese në këtë çështje penale, ishte nëse se i pandehuri L.A., ditën kritike a kishte tentuar ta privoj nga jeta A.D. ashtu siç është e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës.

Trupi gjykues, pas administrimit të gjitha provave personale dhe materiale në shqyrtim kryesor në kuptim të nenit 7 dhe 360 të KPP-së, ka gjetur se nuk është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet si në aktakuzën e ish Prokurorisë Publike të Qarkut, tani Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Departamenti për Krime të Rënda.

Në veprimet e përshkruara në dispozitivin e akuzës për të pandehurin L.A., nuk plotësohen të gjitha elementet e përcaktuara në ligj, përkatësisht nuk është vërtetuar se i pandehuri, ditën kritike, ka tentuar të privoj nga jeta A.D.

Gjykata nuk ka arritur të vërtetoj pretendimet e prokurorisë si në aktakuzë se i pandehuri ditën kritike, përkatësisht me datë 20.02.2002, me dashje ka filluar kryerjen e veprës penale, pas një mosmarrëveshje, e ka grushtuar A.D në kokë disa herë dhe ka nxjerrë thikën dhe ka dashur që ta prej në fyt, por që nuk ka arritur pasi që është penguar nga konduktori – i dëmtuari E.U., të cilit i ka shkaktuar plagë në dorën e djathtë.

Nga administrimi i provave materiale, Gjykata nuk ka arritur të vërtetoj se i akuzuari me dashje, ka filluar të kryej veprën penale të vrasjes në tentativë.

Gjykata, para vlerësimit të provave personale dhe materiale lidhur me këtë çështje lëndore, fillimisht rikujton, në kontekstin ligjor dhe atë doktrinar, veprën penale për të cilën akuzohet i pandehuri sipas pikës I të dispozitivit.

Vepra penale e Vrasjes në tentativë, bënë pjesë në grupin e veprave penale kundër jetës dhe trupit. Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje, qoftë me dashje direkte apo eventuale. Tentativa si institut në të drejtën penale, nënkupton ndërmarrjen e veprimit në drejtim të realizimit të kryerjes së veprës penale, e cila në këtë rast nuk realizohet në tërësinë e saj përkatësisht nuk realizohen të gjitha elementet e veprës penale. Sipas interpretimit të dispozitës ligjore sa i përket institutit të tentativës dhe bazuar edhe në praktikën gjyqësore dhe në shkencën juridike penale, për tu konsideruar se është realizuar tentativa e kryerjes së veprës penale, kumulativisht duhen plotësuar tri kushte: e para që të ndërmerret veprimi i kryerjes së veprës penale, e dyta që veprimi të ndërmerret me dashje dhe e treta që vepra penale të mos përfundohet, përkatësisht të mos shkaktohet pasoja.

Momenti i ndërmarrjes së veprimit me qëllim kryerjen e veprës penale, sipas doktrinës juridike është i rëndësishëm për faktin se në këtë moment mund të përcaktohet kufiri midis asaj që nuk është e ndëshkuar e që ka të bëjë me veprime përgatitore dhe asaj që është e ndëshkuar, e që ka të bëjë me veprimin e kryerjes së veprës penale.

Sa i përket dashjes, ky element është jashtëzakonisht i rëndësishëm me qëllim të përcaktimit nëse një person ka dëshiruar, ka vendosur dhe ka qenë i vetëdijshëm për të gjitha tiparet e veprës penale përkatëse. Pra përveçse te vet kryerja e veprës penale bazë, edhe tek tentativa presupozohet personi të jetë i vetëdijshëm dhe të dëshiroj kryerjen e veprës penale. Në këtë kontekst jo cilado ndërmarrje e veprimeve të caktuara nënkupton edhe dashjen e atij personi për të kryer veprën penale. Sikurse te instituti i dashjes në përgjithësi, edhe tentativa mund të kryhet

me dashje direkte dhe eventuale, ndërsa që për të vërtetuar nëse tentativa është kryer me dashje apo jo, kjo vërtetohet nga rrethanat e secilit rast veç e veç.

Përfundimisht sa i përket kushtit të tretë për tu konsideruar e realizuar tentativa e kryerjes së veprës penale, është e domosdoshme që nga veprimi i ndërmarrë me dashje, të mos jetë realizuar pasoja e veprës penale.

Nga Raporti i hetuesit i datës 09.03.2002, vërtetohet se ditën kritike, i dëmtuari E.U., kishte lajmëruar policinë për një problem që kishte pasur në autobusin e tij “Haxhia Trans”, ne mes te Luigj dhe Alfredit, i dëmtuari kishte ndërhyrë dhe ishte lënduar me thikë të mprehtë dhe thika është sekuestruar nga Policia e Kosovës.

Nga fotoalbumi në shkresat e lëndës me gjithsej dy (2) fotografi, shihet një (1) thikë me madhësi 7.3 cm.

Nëse analizohet me kujdes deklarata e të dëmtuarit E.U., i cili sipas përshkrimit faktit të dispozitivit të aktakuzës nuk është i dëmtuar në raport me veprën penale Vrasje në tentativë por është i dëmtuar në kontekst të asaj se ka ndërhyrë mes L. dhe A. dhe në momentin që ka kapur thikën nga L., edhe është prerë në dorë.

Ky dëshmitar në deklaramet e tij që ka dhënë gjatë hetimeve, kishte deklaruar se kishte vërejtur të pandehurin L. kur ishte ulur prapa A., e kishte nxjerrë thikën dhe kishte dashur, siç shprehet dëshmitari “*të ia hjekë krytë A.*” megjithatë një pretendim i tillë i dëshmitarit për gjykatën mbetet vetëm pretendim por i pa provuar. Kjo për shkak se dëshmitari as në polici por as para gjyqtarit hetues, nuk kishte sqaruar se në çfarë forme kishte ardhur deri të përfundimi se i pandehuri kishte dashur “*të i`a heqte krytë A.*”, pra nga përmbajtja e kësaj deklarate, sipas vlerësimit të gjykatës, kemi më tepër konkluzion subjektiv të nxjerrë nga dëshmitari, se sa prova që dëshmojnë se i pandehuri kishte dashur që të realizonte veprën për të cilën akuzohet. Ky dëshmitar përkundër që kishte qenë okular në vendngjarje, nuk kishte përshkruar në mënyrë të detajuar se cili kishte qenë veprimi i ndërmarrë nga ana e të pandehurit L. në drejtim të realizimit të figurës së veprës penale të vrasjes në tentativë. Në këtë kontekst, dëshmitari përveç që kishte treguar se i pandehuri L. kishte nxjerrë thikën, nuk kishte arritur të tregonte se në çfarë pozicioni po e mbante thikën i pandehuri, a e kishte drejtuar i njëjti thikën në drejtim të personit A., nëse po në cilën pjesë të trupit e kishte drejtuar thikën, a kishte tentuar ta godasë me tehun e thikës apo ta prej ashtu siç është pretendimi në aktakuzë, deri në çfarë distance e kishte afruar thikën.

Në raport me pozicionin e dëshmitarit E.U. në momentin kur ishte zhvilluar kjo ngjarje, gjykata ka analizuar dhe krahasuar dëshminë e këtij dëshmitari me deklaratën e dëshmitarit K.M., i cili para gjyqtarit hetues kishte deklaruar se në momentin që i pandehuri ia ka afruar thikën A., ai ishte ngritur dhe kishte shkuar tek konduktori dhe shoferi e ku në këtë moment konduktori E. ishte ngritur dhe e kishte kapur L. për dore. Pra nëse analizojmë deklaratën e dëshmitarit E. me atë të dëshmitarit K. lidhur me faktin se ku kishte qenë dëshmitari E. në momentin kur i pandehuri kishte nxjerrë thikën, rezulton se ka mospërputhje ndërmjet deklaramëve të këtyre dy dëshmitarëve për këtë çështje.

Gjykata nuk ka mundur të ia falë besimin deklaratës së dëshmitarit E.U. për shkak se siç u theksua më lart, i njëjti përveç që kishte dhënë një vlerësim subjektiv të tij se i pandehuri kishte dashur “*të i`a heqë krytë A.*”, nuk kishte dhënë asnjë detaj lidhur me dinamikën e ngjarjes së zhvilluar, detaje këto që kanë të bëjnë me pozicionin trupor të palëve të përfshira në konflikt, nëse i pandehuri kishte dashur apo kishte ndërmarrë veprimin me thikë me qëllim goditjen apo prerjen e personit A. nëse po në çfarë distance kishte pasur thikën i pandehuri L. nga A., pra në mungesë të këtyre detajeve gjykata nuk ka mundur të ia falë besimin një dëshmie të tillë.

Pra në kontekst të interpretimit të institutit të tentativës ashtu siç u sqarua më lart, e në raport me dëshminë e dëshmitarit E.U. përkatësisht me përshkrimin e ngjarjes të cilën e kishte bërë ky dëshmitar në fazën e hetimit, rrjedhë se nuk janë plotësuar të gjitha elementet e figurës së veprës penale vrasje në tentativë, pra vetëm fakti se i pandehuri ka nxjerrë thikën, nuk konsumon figurën e veprës penale për të cilën i njëjti akuzohet dhe veprimet e përshkruara nga ana e dëshmitarit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nuk janë veprime të cilat kanë qenë të drejtuara në drejtim të realizimit të figurës së veprës penale por eventualisht mund të bëhet fjalë për veprime përgatitore të cilat në këtë rast nuk janë të ndëshkueshme apo eventualisht mund të bëhet fjalë për përdorim të armës në formë kanosëse, por assesi për veprën penale të vrasjes në tentativë.

Për më tepër, duhet theksuar se ky dëshmitar ka dhënë dëshminë e tij para policisë dhe para gjyqtarit hetues, por asnjëherë nuk është arritur të ballafaqohet nga ana e mbrojtjes por edhe nga ana e gjykatës lidhur me deklaramet e tij, andaj në kuptim të dispozitës së nenit 257 paragrafi 1 të KPP-së, gjykata është e kufizuar dhe nuk mund t’i jap vlerën e provës vendimtare një dëshmie apo dëshmitari e cila nuk është arritur të ballafaqohet në ndonjë apo cilëndo fazë të procedurës penale nga ana e mbrojtjes.

Nga vlerësimi i deklaratave të dëshmitarit SH.O., gjykata nuk ka mundur të vërtetoj elementet e figurës së veprës penale për të cilin akuzohet i pandehuri. Fillimisht gjykata rikujton se dëshmitari i dëgjuar në shqyrtim kryesor, nuk ka arritur të kujtonte pothuajse asgjë në raport me faktet vendimtare për atë se si kishte ndodhur ngjarja në ditën kritike, por parimisht ka mbetur pranë deklarimeve të cilat i kishte dhënë në fazat e mëparshme. Nga analizimi i deklarimeve të këtij dëshmitari të dhëna në polici dhe para gjyqtarit hetues, gjykata ka arritur të vërtetoj disa fakte që në esencë nuk ishin kontestuese mes palëve dhe kjo lidhur me atë se ndërmjet të pandehurit dhe personit me emrin A., në ditën kritike kishte ndodhur një mosmarrëveshje, përkatësisht konflikt mirëpo as në polici, e as para gjyqtarit hetues, ky dëshmitar nuk kishte pohuar se këtu i pandehuri kishte dashur ta vrasë personin me emrin A., përkundrazi ky dëshmitar në dëshminë e tij kishte theksuar se kishte qenë pikërisht A. ai i cili e kishte sulmuar L., mirëpo një deklaram i tillë i këtij dëshmitari nuk gjen mbështetje në provat personale dhe materiale dhe madje është në kundërshtim edhe me vet deklaramin e të pandehurit L. i cili kishte pohuar faktin se A. kishte pasur sprejin me vete, mirëpo në asnjë moment nuk kishte pohuar faktin se ishte sulmuar me sprej nga ana e A., për këto arsye nga dëshmia e këtij dëshmitari gjykata nuk ka arritur të vërtetoj pretendimet e prokurorisë si në pikën I të dispozitivit të akuzës.

Nga dëshmia e dëshmitarit S.A. dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 14.07.2022 dhe deklaratat e tij të dhëna para gjyqtarit hetues dhe në polici, gjykata ka vërtetuar faktin se ditën kritike në autobusin që qarkullonte në relacionin Skenderaj-Mitrovicë kishte pasur një konflikt ndërmjet të pandehurit L. dhe A.D. t dhe se gjatë këtij konflikti, i pandehuri kishte nxjerrë edhe thikën me q ‘rast kishte ndërhyrë konduktori E.U., i cili ia kishte kapur thikën L. ku edhe e kishte prerë dorën, e pas të cilës dëshmitari bashkë me të pandehurin kishin zbritur nga autobusi për të vazhduar në shtëpi.

Megjithatë nga dëshmia e këtij dëshmitari, gjykata nuk ka arritur të vërtetoj pretendimet si në dispozitiv të aktakuzës se i pandehuri ka dashur që “ta prejë në fyt A.D.”. Nga vlerësimi dhe analizimi i deklaratës së këtij dëshmitari, gjykata nuk ka mundur të vërtetoj ndërmarrjen e veprimeve nga ana e të pandehurit Luigj që do të plotësonin figurën e veprës penale të vrasjes në tentativë. Nga dëshmia e këtij dëshmitari, gjykata nuk ka mundur të vërtetoj nëse i pandehuri ka përdorur thikën në kuptim të asaj që i pandehuri ka tentuar ta godasë A.D. për shkak se siç ka deklaruar ky dëshmitar, në momentin që i pandehuri ka nxjerrë thikën, të njëjtin ia ka kapur konduktori i autobusit E.U. dhe pas një kohe të shkurtër edhe kanë zbritur nga autobusi.

Nga dëshmia e dëshmitarit B.H., gjykata ka vërtetuar atë që në fakt nuk ishte kontestuese mes palëve, faktin se ditën kritike në autobusin të cilin po e drejtonte pikërisht ky dëshmitar, kishte ndodhur një konflikt ndërmjet të pandehurit dhe A.D. dhe se nga ky konflikt, i lënduar kishte mbetur ndihmësi i tij E.U. i cili kishte ndërhyrë për ti ndarë me q ‘rast edhe ishte prerë në dorë. Megjithatë nga dëshmia e këtij dëshmitari gjykata nuk ka arritur të vërtetoj gjendjen faktike si në aktakuzë, përkatësisht pretendimet e akuzës se i pandehuri ka dashur “*ta prejë në fyti*” A.D. pasi që siç ka deklaruar dëshmitari, i njëjti kishte qenë duke e drejtuar autobusin dhe nuk e ka parë momentin kritik se si ka rrjedhur ngjarja.

Nga dëshmia e dëshmitarit K.M. të dhënë në shqyrtimet kryesore dhe në fazën e hetimeve, gjykata nuk ka arritur të vërtetoj pretendimet si në aktakuzë. Nga deklarata e këtij dëshmitari, gjykata ka vërtetuar disa fakte që nuk ishin kontestuese, e që kanë të bëjnë me atë që në ditën kritike, në vendin dhe kohën si në dispozitiv të aktakuzës kishte ndodhur një konflikt mes të pandehurit dhe A.D., faktin se ditën kritike i pandehuri kishte pasur thikë me veti dhe faktin se konduktori E.U., në momentin kur kishte ndërhyrë për të ia marrë thikën L. ishte prerë në dorë. Megjithatë nga dëshmia e këtij dëshmitari, gjykata nuk ka arritur të vërtetoj se në veprimet e të pandehurit janë konsumuar elementet e veprës penale për të cilën akuzohet. Fillimisht duhet sqaruar se në raport me këtë dëshmitar, i njëjti si në seancën e datës 01.06.2022, ashtu edhe në atë të datës 13.02.2025, ka deklaruar se për ngjarjen nuk i kujtohet pothuajse asgjë, mirëpo ka qëndruar pranë deklarimeve të mëparshme. Në deklaratën të cilën dëshmitari kishte dhënë në polici me datë 21.02.2002, kishte theksuar ndër të tjera se në ditën kritike, personat S.O, L.O. dhe SH.O. kishin tentuar ta zbresin nga autobusi shokun e tij A. me qëllim për ta rrahur, se ata kishin qenë ulur mbrapa A. ku kishin tentuar ta therrin me thikë A., mirëpo kishte ndërhyrë konduktori E. ku edhe ishte prerë me thikë nga L. ndërsa në deklaratën që ky dëshmitar kishte dhënë para gjyqtarit hetues me datë 12.01.2004, ndër të tjera kishte theksuar se kur L. ishte ulur pas tyre, dëshmitari i kishte propozuar A. që të ngritët nga vendi sepse diçka e keqe do të ndodhte, e ku në ato momente L. ishte ngritur, e kishte nxjerrë thikën me dorë të majtë, e kishte mbështjellë kokën e A. në pjesën e ballit, e kishte tërhequr pakëz mbrapa dhe ia kishte afruar thikën diku 3cm në afërsi të fytit, mirëpo nuk kishte mundur më shumë pasi që A. nga frika, me vrull ishte ngritur dhe përmbi ulëse kishte shkuar tek konduktori dhe shoferi.

Nëse analizohen këto dy deklarata të këtij dëshmitari vërehet se ka një jo konsistencë për disa çështje thelbësore për rastin. Fillimisht përderisa në polici kishte deklaruar se “ata persona kishin tentuar ta godasin me thikë A.”, para gjyqtarit hetues kishte dhënë një version relativisht të ndryshëm nga ajo që kishte thënë në polici ku kishte përshkruar se si i pandehuri L.ia kishte

afruar thikën afër fytit 3cm. Përveç jo konsistencës së dëshmisë së këtij dëshmitari, megjithatë gjykata nuk ka arritur të vërtetoj se me cilin veprim konkret të të pandehurit është tentuar kryerja e veprës penale nga ana e të pandehurit ashtu siç pretendohet në aktakuzë, pra dëshmitari përkundër që kishte qenë okular në vendngjarje, nuk ka mundur të sqaroj se në çfarë pozicioni ka mbajtur thikën i pandehuri, në cilën pjesë të trupit ka tentuar ta godasë për shkak se përderisa herën e parë në polici kishte deklaruar se është tentuar të goditet A., herën e dytë para gjyqtarit hetues kishte deklaruar se i pandehuri ia kishte afruar thikën te fyti në distancë afër 3cm, pra ka dallim të madh në deklarin e dëshmitarit për këtë rrethanë e që e bënë të pabesueshëm për këtë gjykatë deklarin e të njëjtit.

Në raport me deklarin e këtij dëshmitari para gjyqtarit hetues, edhe sikur gjykata t`ia kishte falur besimi deklarin të dëshmitarit, nga përmbajtja e kësaj deklarate, në kontekst të interpretimit të veprës penale të vrasjes në tentativë, nuk do të plotësoheshin elementet e figurës së veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri. Kjo për shkak se ky dëshmitar në deklaratën e dhënë para gjyqtarit hetues kishte deklaruar se i pandehuri ia kishte afruar thikën A. në një distancë deri në 3cm, por në asnjë moment dëshmitari nuk kishte deklaruar se i pandehuri ka tentuar ta godasë me thikë A.. Në këtë kuptim nëse marrim si të mirëqenë këtë deklarin të këtij dëshmitari, sipas vlerësimit të kësaj gjykate i pandehuri ka pasur të gjitha mundësitë praktike për të kryer veprën për të cilën akuzohet, për shkak se sipas dëshmitarit, i pandehuri ka qenë ulur mbrapa A. dhe po të donte i pandehuri ta godiste me thikë, do ta kishte bërë këtë pa asnjë pengesë.

Gjithashtu ky dëshmitar, në polici kishte deklaruar se “*djelmoshat nga Klina*”, kishin thika, një revole dhe një shufër hekuri, ndërsa që para gjyqtarit hetues nuk kishte përmendur një fakt të tillë dhe përveç se nuk e kishte përmendur në deklaratën e dytë këtë fakt, kjo nuk është thënë nga asnjë prej dëshmitarëve tjerë çka deklarin e tillë të dëshmitarit, e bënë të pabesueshëm.

I pandehuri L.A. në shqyrtim gjyqësor është mbrojtur në heshtje mirëpo ka mbetur pranë deklarinëve të dhënë në fazat e mëhershme, ku ndër të tjera kishte deklaruar se ditën kritike kishte qenë së bashku me vëllain e tij S. dhe kushëririn SH.O., kishte ndodhur një mosmarrëveshje mes tij dhe A.D. pasi që pa dashje e ka shkelur me këmbë një kushëri të tij, për këtë A. ishte zemëruar shumë, e ka nxjerr sprejin prej xhepi, nga frika, i pandehuri e ka nxjerr thikën nga xhepi në mënyrë që të mbrohet, nuk ka tentuar ta sulmoj e as ta privoj nga jeta askënd, nuk e ka goditur askënd, ndërsa konduktori E. duke ja marr thikën, është lënduar.

Gjykata ka vlerësuar mbrojtjen e të pandehurit dhe e njëjta është pjesërisht e besueshme pasi që gjen mbështetje edhe në provat e administruara. Për gjykatën, kjo mbrojtje e të pandehurit se ditën kritike kishte një konflikt me A.D, se gjatë këtij konflikti kishte nxjerrë thikën, se A. nuk

kishte pësuar lëndime trupore mirëpo lëndime në dorë kishte pësuar E.U. gjatë përpjekjes së tij për t'i ndarë, gjen mbështetje në provat materiale siç janë foto dokumentacioni, por edhe në provat personale siç janë deklaratimet e të dëmtuarit E.U., dëshmitari K.M., si dhe dëshmitarit B.H. Për gjykatën është e pabesueshme mbrojtja e të pandehurit sa i përket motivit se për çka ka ardhur deri tek konflikti ndërmjet tij dhe A.D. për shkak se nuk është arritur të vërtetohet me provat e administruara, por se kjo çështje nuk është e rëndësisë së tillë që do të ndryshonte diçka nga ajo që është vendosur në dispozitiv.

Andaj Gjykata vlerëson se në veprimet e të akuzuarit, nuk mund të vërtetohet dashja për të kryer veprën penale të vrasjes, pasi kjo vepër si element të veçantë apo kryesor ka dashjen, e që në rastin konkret, i akuzuari ka pasur lehtësisht mundësi që ta kryej këtë vepër penale, sikur të ekzistonte dashja e tillë. Sipas vlerësimeve të kësaj Gjykata, sikur të ekzistonte dashja e të akuzuarit në këtë rast, ai ka poseduar mjetin dhe mundësinë e përshtatshme për të realizuar synimin tij. Siç edhe është konstatuar më lart, gjatë përleshjes i akuzuari L.A. e ka poseduar një thikë si mjet i përshtatshëm dhe i rrezikshëm që mund të shkaktoj pasoja shumë të rënda. Kjo rrethanë tregon se i akuzuari ka pasur mjetin dhe mundësinë për të përfunduar veprën penale, pra ka pasur mundësi reale që ta privojë nga jeta A., duke qenë se e ka poseduar thikën. Gjykata pas leximit të deklaratave të të dëmtuarit E.U. dhe dëshmitarëve, gjeti se i pandehuri nuk ka përdorur thikën me qëllim realizimin e kryerjes së veprës penale për të cilën akuzohet dhe gjithashtu nuk ka pasur për synim të dëmtuarin E.U. pasi që i njëjti është lënduar gjatë ndërhyrjes së tij për ta ndarë të pandehurin L.A. dhe A.D. fakt i cili u vërtetua dhe nga vetëpohimi i të dëmtuarit E.U. dhe dëshmitarëve në shqyrtimin gjyqësor, por edhe nga vet deklarimi i të pandehurit.

Nga ajo që u theksua më lartë, për përgjegjësinë penale të kryerësit për veprën penale-Vrasje në tentativë nga neni 30 të LPK-së, lidhur me nenin 19 të LPJ-së, kryerësi është penalisht përgjegjës vetëm nëse ka vepruar me dashje dhe me qëllim që ta privojë të dëmtuarin nga jeta. Si përfundim, në rastin konkret Gjykata ka konstatuar se tek i akuzuari nuk ka ekzistuar asnjëra nga format e dashjes (direkte apo eventuale) dhe në një gjendje të tillë faktike përtej kësaj, Gjykata ka konstatuar se nga i njëjti nuk janë plotësuar elementet e veprës penale të Vrasjes në tentativë nga neni 30 të LPK-së, lidhur me nenin 19 të LPJ-së.

Në dispozitën ligjore nga neni 13 të LPJ-së është përcaktuar se: *“Vepra penale është kryer me dashje kur kryerësi ka qenë i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e ka dashur kryerjen e saj; apo*

ka qenë i vetëdijshëm se për shkak të kryerjes ose të mos kryerjes së saj pasoja e ndaluar mund të vijë por e ka pranuar ardhjen e saj.”.

Trupi gjykues, siç mund të kuptohet nga nën teksti i arsytimit të këtij aktgjykimi në raport me deklaratimet e dëshmitarëve dhe gjendjen e fakteve, ka pasur parasysh se në veprimet e të pandehurit kanë mundur të konsumohen elemente të veprave të tjera penale, siç është vepra penale Pjesëmarrja në rrahje nga neni 40 i LPK-së, Rrezikimi me mjet të rrezikshëm gjatë rrahjes ose grindjes nga neni 41 të LPK-së, apo vepra penale Mbajtja pa leje e armëve ose materieve plasëse nga neni 199 i LPK-së, mirëpo që në çfarëdo rasti të rikualifikimit eventual të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, në ndonjërin nga veprat penale të cekura më lart, për shkak të kohës së kaluar nga kryerja e veprës penale deri tash, do të rezultonte me aktgjykim refuzues për shkak të arritjes së afateve të parashkrimit të ndjekjes penale.

Gjykata, rikujton një parim kryesor të procedurës penale *”In dubio pro reo”*, përcaktuar në nenin 3 paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se *“Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të akuzuarit dhe të drejtave të tij”*. Prandaj, duke qenë se Gjykata nuk ka arritur ta vërtetojë përtej çdo dyshimi se i akuzuari ka kryer këtë vepër penale, prandaj edhe ka vendosur si në dispozitiv.

Vendimi lidhur mbi Konfiskimin:

Gjykata, duke u bazuar në dispozitën e nenit 276 paragrafi 1 dhe 2, nën paragrafi 2.1 të KPP-së, ndaj të akuzuarit urdhëroi konfiskimin e përhershëm të thikës me gjatësi 7.3 cm, dhe për të njëjtën ka urdhëruar Policinë e Kosovës që ta shkatërroj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike:

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, duke e udhëzuar palën e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt civil, bazuar në nenin 462 paragrafi 3 të KPP-së, në të cilin përcaktohet se *“Kur gjykata merr aktgjykim me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza ose me të cilin akuza refuzohet apo kur me aktvendim pushohet procedura penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest civil...”*.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës:

Për shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në nenin 453 par.1 të KPP-së, në të cilin përcaktohet se *“Kur pushohet procedura penale apo kur merret aktgjykimi me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza ose me të cilin refuzohet akuza, gjykata në aktvendim apo në aktgjykim shënon se shpenzimet e procedurës penale nga neni 449, paragrafi 2 nën-paragrafi 2.1 deri në 2.5 të këtij Kodi, shpenzimet e nevojshme të të akzuarit dhe kompensimi i shpenzimeve të nevojshme të mbrojtësit paguhet nga mjetet buxhetore...”*.

Andaj Gjkata, duke u bazuar me neni, 7, 359, 360, 363, 449, 453 dhe 462 të KPP-së nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.26/2007, datë 14.03.2025

Zyrtarja ligjore
Doruntina BEKA

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari
Xhemajl JUSUFI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.

Numri i lëndës: 2019:104546
Datë: 14.03.2025
Numri i dokumentit: 06995103